



Pranga / Priloge Punë / Priloge	10.08	2023	3	viti / god. year
Organ / Organizata Org. / Org.	KRMShCK	5602/	2023	116



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.517/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1788/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative të datës 11.07.2023, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.528/2019 të datës 10.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Vendimit me Nr. Prot:171 të datës 09.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 10.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.528/2019 e datës 10.09.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.Prot:171 i datës 09.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe Vendimi Nr.Prot:331 i datës 13.06.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës nëpërmjet postës me datë 09.09.2019 ka parashtruar ankesë e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 10.09.2019 me numër protokollit 4248/2019, kundër Vendimit me Nr. Prot:171 të datës 09.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon s akti i kontestuar është i kundërligjshëm ngase e me rastin e transferimit të tij, institucioni punëdhënës ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material, gjegjësisht Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e lënies në fuqi të Vendimit të datës 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së përmes të cilit është shfuqizuar Akt emërimi i ankuesit i datës 28.02.2014, ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale ngase akt i emërimit në fjalë ka qenë i karrierës apo pa afat.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 18.09.2019 e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Administratën Tatimore të Kosovës. Më datë 17.10.2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administratën Tatimore të Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 24.10.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 01.06.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2910/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 24.10.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 10.09.2019, ndërsa Këshilli asaj kohe ka qenë jo funksional dhe nuk kishte vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa e kemi udhëzuar sërish ankuesin që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 11.07.2023 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1788/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e datës 07.07.2021 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për shqyrtimin e kësaj çështje administrative, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 10.09.2019 me numër protokolli 4248/2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Prot:171 të datës 09.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Akt Emërimin me numër prot:02/408/2014 e datës 28.02.2014 të ankuesit; Formulari i vlerësimeve individuale i datës 12.08.2011; Vendimin me numër protokolli:331 i datës 13.06.2019, Akt Emërimin me numër prot:02/408/2014 e datës 28.02.2013; Akt Emërimin me numër prot:02/408/2014 e datës 23.02.2012; Kontratën e punës me numër prot:02/408/2014 e datës 15.08.2011; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 18.09.2019;

Përgjigja në ankesë e datës 18.10.2019; E-maili i datës 09.08.2019; E-maili i datës 24.06.2016; Struktura e Përgjithshme Organizative e Administratës Tatimore; Rregullorja Nr. ATK-13/2019; E-maili i datës 16.05.2016; Ankesën e datës 12.06.2016 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Shkresën e datës 10.09.2019 me numër protokoll 2781Vendimin me Nr. Prot:171 i datës 09.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimin e datës 13.06.2019 me numër:09-06-2528 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së; Aktgjykim A.nr.1788/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 11.07.2023; Aktgjykim A.nr.2910/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 01.06.2021; Njoftimin e datës 24.10.2019 dhe 07.07.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se, ankuesi sipas Akt Emërimit me numër:02/408/09 të datës 28.02.2014 ka qenë i emëruar në pozitën "Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Përkrahje" në Administratën Tatimore të Kosovës. Tutje, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, më datë 13.06.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 09-06-2528 me të cilin ka bërë shfuqizimin e Akt Emërimit për pozitën e ankuesit, ndërsa po të njëjtën ditë, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës përmes Vendimit me numër prot:331 të datës 13.06.2019 ankuesin e cakton në pozitën "Ushtrues Detyre të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Mbështetje të Programeve".

Ankuesi kundër vendimit të datës 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, më datë 12.07.2019 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:11-06-2891 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, më datë 09.08.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:171 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi Vendimin me Nr. 09-06-2528 të datës 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me numër protokoll 331 i datës 13.06.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, për caktimin e ankuesit Hamit Mulaj, nga pozita "Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Përkrahje" në pozitën "Ushtrues Detyre të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Mbështetje të Programeve", është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikës të Kosovës ku përcaktohet se: "Nëpunësit civilë, me urdhër nga eprori, janë të detyruar që përkohësisht ta zëvendësojnë një koleg i cili mungon ose ta plotësojnë një vend të lirë të punës, nëse veprimtaria e zakonshme e institucionit do të pengohet nga mungesa e nëpunësit civil. 2. Në rast të mungesës së një sekretari të përgjithshëm apo pozicioni ekuivalent, ai/ajo do të zëvendësohet nga nëpunësi civil i rangut më të lartë në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin për procedurën administrative. 3. Refuzimi për zëvendësimin e një nëpunësi civil, që mungon në raste emergjente, konsiderohet pengim i veprimtarisë administrative dhe iu nënshtrohet masave disiplinore. 4. Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj.", ngase në aktin e goditur askund në përcaktohet në mënyrë të sakt periudha kohore sa do të ushtrojë pozitën në cilësi të "Ushtruesit të Detyrës të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Mbështetje të Programeve" sikurse Vendimi me

numër protokoli 331 i datës 13.06.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së është në kundërshtim me dispozitat e nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku specifikohet se: "1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë" nga rrjedh se një vendim i tillë është i paligjshëm sikurse përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: "1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkëljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material" për shkak se Vendimi numër protokoli 331 i datës 13.09.2019 nuk përmban arsyetimin e nevojshëm, bazën e zbatueshme ligjore në rastin konkret dhe as këshillën juridike sikurse i njëjti është në kundërshtim edhe me ligjin material ngase në rastet e caktuara periudha maksimale sa një pozitë mund të uhstrohet me ushtrues detyrë është tre (3) muaj, ndërsa vendimi në fjalë nuk e ka përkufizuar sakt periudhën kohore dhe po ashtu dispozitave të referuara në premabulën e vendimit të goditur sikurse janë neni 53-58 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative janë të pakuptueshme në rrethanet e rastit konkret ngase përmes këtij akti dhe nga dispozitiv i të njëjtët nuk është zhfuqizuar asnjë akt tjetër, prandaj për arsyet e dhëna si më lartë për shkak të kundërligjshmërisë së tij Vendimi numër protokoli 331 i datës 13.06.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Po ashtu, duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se një akt administrativ si i tillë është i paligjshëm nëse është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, konstatojmë se Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoli 331 të datës 13.06.2019 për caktimin e ankuesit Hamit Mulaj, nga pozita "Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Përkrahje" në pozitën "Ushtrues Detyrë të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Mbështetje të Programeve" ka vepruar në kundërshtim dhe me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, që është përcaktuar se: "Nëpunësve civilë u garantohet mbrojtja kundër çfarëdo largimi të paarsyeshëm ose të panevojshëm nga vendi i tyre i punës ose ndryshimi i qëndrimit në detyrë", si dhe caktimi i ushtruesit të detyrës në frymën e formë të ricaktimit në vend tjetër të punës është bërë në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 6 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: " Kushtet e punësimit të mos jenë më të disfavourshme se ato që i ka pasur në vendin e punës", që në rastin konkret ankuesi sipas aktit të emërimit të datës 28.02.2014 ka qenë i emëruar i karrierës apo pa afat, ndërsa përmes Vendimit me numër protokoli 331 të datës 13.06.2019 i është krijuar pasigurij juridike e ruajtjes së vendit të punës, andaj Kolegji i Këshillit mbi bazë të analizimit të këtyre rrethanave konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit është i bazuar.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit ndërlidhur me arsyetimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së dhe bazës ligjore lidhur me shfuqizimin e aktit të emërimit të ankuesit dhe caktimin tij në pozitën Ushtrues Detyre të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Mbështetje të Programeve, ka gjetur se me rastin e nxjerrjes së Rregullores së datës 17.05.2019 nga ATK-ja, është konstatuar se përmes shkresës zyrtare të datës 10.09.2019 me numër protokollit 2781, Ministria e Administratës Publike kishte konstatuar se nuk janë respektuar dispozitat e ligjit Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura nga Administrata Tatimore e Kosovës me rastin nxjerrjes së Rregullores nr.ATK-13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës të datës 17.05.2019, sepse nuk ju ka nënshtruar procedurave ligjore siç e përcakton Ligji Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe Ministria përkatëse e Administratës Publike konstaton pamundësinë e aprovimit të pozitave të lira si rezultat i dilemave që ekzistojnë në organizimin e brendshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, andaj nga kjo shkresë zyrtare nga një organë kompetentë mund të nxjerret përfundimi se Administrata Tatimore e Kosovës, me as një provë nuk ka dëshmuar se ka miratim nga Kryeministri dhe nga Ministria përgjegjëse në pajtim me nenin 28 paragrafi 3 dhe 6 i Ligjit Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura ku përcaktohet se: *"3.Organizimi i brendshëm i ministrive dhe agjencive ekzekutive miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat; 6. Qeveria e Kosovës, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton Rregulloren për standardet të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, procedurat e detajuara për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm, si dhe përmbajtjen e memorandumit shpjegues të propozimit"*, andaj nga ajo që u tha më lartë dhe që u vërtetua përmes shkresave të lëndës nga Kolegji i Këshillit u konstatua se nuk ka pasur aprovim konformë nenit 28 paragrafi 3 dhe 6 të Ligjit Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura me rastin e nxjerrjes së Rregullores Nr.ATK-13/2019 të datës 17.05.2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës dhe mbi këtë bazë pretendimet e ankuesit janë të bazuara, sepse vendimi me numër protokollit 331 i datës 13.06.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës mbi ricaktimin është i pabazuar dhe se është mbështetë në një dokumentë që nuk prodhon efekte juridike përderisa nuk nxjerret konformë dispozitave përkatëse ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 171 të datës 09.08.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, ngase me rastin e shqyrtimit të ankesës nuk ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil me rastin e vendosjes meritore, pasi nuk ka marrë për bazë pretendimet ankimore dhe se nuk i ka trajtuar meritorisht të gjitha sikurse përcaktohet me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme Administrative sikurse përcaktohet se: *"Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve"*.

Po ashtu, Vendimit me numër protokolli 171 të datës 09.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është në kundërshtim edhe me legjislacionin në fuqi që rregullon qështjen e protokolimit të një akti administrativ, ngase nga përmbajtja shihet se vendimi nga komisioni është marrë më datë 16/07/2019 ndërsa është protokoluar më datë 07/08/2019, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyre dhe nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Udhëzimit Administrativë 01/2017 për Administrimin e Punës në Zyre, andaj edhe mbi këtë bazë vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës të meta përmbajtësore në aspektin ligjor, me që rastë e bënë të bazuar pretendimin sa i përket bazës ligjore me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi të kontestuar nga ankuesi, prandj i njëjtë është shfuqizuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi. .

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.517/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMShCK-së.